



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 936/prot.  
1

Tiranë më 30.5.2018

Lënda: Mendim mbi projektvendimin "Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga AIDSSH"

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.16416, Prot., datë 24.05.2018, me anë të së cilës kërkonti mendim mbi projektvendimin "Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit", Zyra e Komisionerit vijon ti mbetet sugjerimit të dhënë edhe më parë me shkresën nr. 1507/1, datë 20.11.2017, lidhur me uljen e tarifave të shërbimit, bazuar në pikën 2 të nenit 13 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Është e një rëndësie të veçantë mbajtja parasysh e parimeve të ligjit për të drejtën e informimit, ku tarifat për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar të jenë të orientuara në kosto. Ligji për të drejtën e informimit rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, dhe vendosja e një tarife të lartë do të përbënte pengesë për garantimin e njohjes së publikut me informacion.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

